

Tenderë të turbullt milionësh për pajisje hidraulike



Kompania për pajisje hidraulike "Tehnoskop" në 10 vitet e fundit, ka lidhur mbi 200 kontrata për prokurime publike me vlerë rreth 17.5 milionë euro, para së gjithash, me ndërmarrjet publike komunale me në krye ujësjellësin e Shkupit, shërbimi i prokurimit publik i të cilës menaxhohet nga nëna e një të punësuarë në kompaninë. Sipas të dhënave zyrtare që i siguroam nga institucionet kompetente, ndërmarrjet komunale janë të grupuara në shoqatën "ADKOM", personi i autorizuar i të cilës është gruaja e pronarit dhe motra e menaxherit të "Tehnoskop". Deri më tani, kompanitë konkurrenente kanë kontestuar një sërë procedura tenderime para Komisionit për ankesa mbi prokurimet publike, duke fajësuar për diskriminim dhe favorizim, ndërsa rastin e heton Komisioni anti-korrupsion!

Shkruan Vllatko STOJANOVSKI

Vetëm në njëzet vitet e fundit, kompania "Tehnoskop" ka nënshkruar 200 kontrata për prokurime publike, vlera totale e të cilave kalon një miliardë denarë ose rreth 17,5 milionë euro, kryesisht me ndërmarrjet publike të vendit. Sipas të dhënave zyrtare të ofruara nga institucionet kompetente, ato



This project is funded by the European Union



janë të grupuara në shoqatën e ofruesve të shërbimeve komunale - ADKOM personi i autorizuar i ë cilës është gruaja e pronarit të vetëm të "Tehnoskop" dhe njëherit është motra e menaxherit të kësaj kompanie. Përveç kësaj, në "Tehnoskop" tash e disa vite punon e bija e udhëheqëses së shërbimit të prokurimeve publike të NP "Ujësjellës dhe Kanalizime - Shkup", me të cilën në fakt kompania nga viti 2008 e deri më tani ka lidhur kontrata me vlerë një total prej rreth 4,5 milionë euro.

Po ashtu, pronari i "Tehnoskop" asokohe ka themeluar edhe një tjetër kompani që operon në këtë sektorin "Matam Ing", pronari aktual i së cilës më herët ka punuar pikërisht në "Tehnoskop". Me këtë rast, të dyja kompanitë kanë garuar ndërmjet veti në një procedurë të tenderit, pasi që janë eliminuar kompanitë e tjera të interesuara nga procesi, gjë që ngre pyetjen nëse këtë treg ekziston konkurrencë jolojale. Në shumë procedura tenderike, "Tehnoskop" ka qenë ofertuesi i vetëm, ngaqë paraprakisht janë skualifikuar të gjithë ofertuesit e tjerë, edhe pse ata fillimisht kanë paraqitur çmime më të ulëta, gjë që tregon për shpenzim të mundshëm irracional të mjeteve publike.

Disa kompani konkurruese, para së gjithash "Kaz Group", kanë kontestuar një sërë procedurash tenderimi për pajisje hidraulike, të zbatuara kryesisht nga NP "Ujësjellës dhe Kanalizime - Shkup" në kuadër të të cilave ka marrë pjesë "Tehnoskop". Në ankesat që i ka parashtruar kompania dhe aktvendimet që i ka miratuar Komisionin kompetent për ankesa mbi prokurimet publike, përmbajnë akuza për trajtim jo të barabartë të operatorëve ekonomik dhe për diskriminim dhe favorizim të kompanive nëpërmjet përgatitjes së paligjshme të dokumentacionit të tenderit dhe specifikacioneve teknike, të cilat parashohin që kompanitë të posedojnë certifikatë specifike në vend të përmbushjes së standardi adekuat. Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktin e Interesave konsideron se ka elemente të mjaftueshme për të kontrolluar mënyrën në të cilën "Tehnoskop" i ka fituar tenderët.

Në kuadër të këtij hulumtimi, konstatojmë se gjatë ekzistencës së vet që nga viti 1994 e deri më tani, "Tehnoskop" ka realizuar të ardhura prej rreth 39 milionë euro, prej të cilave si fitimi kanë mbetur rreth 7.5 milionë euro. Në fakt, një pjesë e konsiderueshme e këtyre flukseve financiare janë rezultat i parave publike, duke qenë se, sipas llogaritjeve, vlera e kontratave për prokurime publike të cilat i ka lidhur kompania në periudhën nga viti 2008 deri në vitin 2018 korrespondojnë me më shumë se gjysma e të ardhurave që i ka realizuar gjatë të njëjtës periudhë. Ajo që është një fakt i



pamohueshëm, pas formimit të ADKOM, kompania shënon rritje financiare.

SHOQATË PARALELE E NDËRMARRJEVE KOMUNALE NË APARTAMENTIN E PRONARIT TË NJË KOMPANIE

Nga "ADKOM" thonë se shoqata është formuar në vitin 2004 me iniciativën dhe me mbështetjen e USAID-it me qëllim të shoqërimit të lirë të qytetarëve dhe ndërmarrjet komunale publike dhe avancimin e veprimtarisë komunale. Edhe krahas asaj që ata theksojnë se anëtarë e shoqatës mund të jetë një ndërmarrje komunale e përfaqësuar përmes punonjësve të saj, por edhe çdo person fizik apo juridik, megjithatë, në faqen zyrtare të internetit të shoqatës ceket se anëtarët e "ADKOM" i përfaqësojnë ndërmarrjet komunale publike në komunat nga të cilat dalin ato. Kalimthi, midis anëtarëve të shoqatës janë listuar në mënyrë taksative rreth tetëdhjetë ndërmarrjet komunale publike të themeluara nga njësitë e vetëqeverisjes lokale, por jo edhe subjekte apo persona të tjerë.

Siç pretendojnë nga "ADKOM", kjo mënyrë e funksionimit është zbatuar në asociacione të tjera, por në mbështetje të kësaj, nuk përmendin asnjë shoqatë tjetër të përbërë nga ndërmarrjet publike. Nga atje vetëm pohojnë se edhe në strukturën e Odës Ekonomike të Maqedonisë (EEM) funksionon Grupacioni për ujësjellës në kuadër të Shoqatës së Veprimtarive Publike, që i bashkon ndërmarrjet komunale publike me një pjesë të kompanive private të këtij sektori. Nga ky pikëvështrim, "ADKOM" vepron si shoqatë paralele e ofruesve të shërbimeve komunale në raport me EEM, me atë dallim që EEM definohet si asociacion farist-profesional sipas Ligjit për Dhomat ekonomike, ndërsa "ADKOM" vepron në bazë të Ligjit për shoqatat dhe fondacionet.

Në statutin e "ADKOM" parashihet se organi më i lartë është Kuvendi i cili i miraton të gjitha vendimet, programet dhe planet financiare për punën e shoqatës. Trupi ekzekutiv i Kuvendit është Bordi Drejtues, i cili për kryerjen e detyrave dhe aktiviteteve të deleguara ka zyrën ekzekutive me punonjësit e saj të cilët kujdesen për realizimin në kohë të detyrimeve. Bordi Mbikëqyrës, ndërkaq, është i autorizuar të mbikëqyrë dhe monitorojë punën e shoqatës në përmbushjen e detyrave të saja, si dhe të bëjë kontroll për diskonim të dedikuar të mjeteve dhe të të ardhurave.

Të dhënat që i morëm nga Regjistri Qendror tregojnë se personi i autorizuar i "ADKOM" pas formimit në vitin 2004 ka qenë **Jordan Millkov**, ish-drejtor i ndërmarrjes komunale publike nga Kavadari. Ai e mbajti këtë post deri në mesin e vitit 2010, kur në vendin e tij vjen **Lolita**



Stojanovska, e cila, sipas informatave të konfirmuara, është bashkëshortja e pronarit të kompanisë "Tehnoskop" **Boshko Stojanovski** dhe motra e menaxherit të kësaj kompanie **Dimitar Popllazarov**. Verifikimet që i kemi kryer në Kadastrën e patundshmërive tregojnë se selia e "ADKOM" është e vendosur në një apartament në komunën e Shkupit Aerodrom në pronësi të njeriut të parë të "Tehnoskop", Stojanovski.



"Selia e ADKOM-it në Aerodrom të Shkupit"

PAS FORMIMIT TË SHOQATËS, JANË RRIUR TË ARDHURAT E KOMPANISË

Pas formimit në vitin 1994 "Tehnoskop" ka pasur dy pronarë, ndërkaq prej viti 2007 Stojanovski paraqitet si pronar i vetëm i kompanisë, ndërsa kunati i tij Popllazarov është drejtues i shoqatës. Me përjashtim të disa viteve, kompania shënon një trend të rritje të vazhdueshme të të ardhurave dhe profitit nga viti në vit, por kjo rritje është më intensive pas formimit të "ADKOM" në vitin 2004 dhe sidomos pas emërimit të Stojanovskës si person i autorizuar i shoqatës në vitin 2010 . Që




This project is funded
by the European Union



atëherë, kompania e bashkëshortit të saj i realizon të ardhurat dhe fitime më të larta në punën e vet.

Një vit pas themelimit në vitin 1994, "Tehnoskop" ka realizuar të ardhura 2.752.379 denarë ose rreth 45.000 euro dhe shpenzime 2.663.654 denarë ose rreth 43.500 euro, që do të thotë se fitimi ka arritur në 88.725 denarë ose rreth 1.500 euro. Në periudhën e ardhshme, të ardhurat e kompanisë, me përjashtim të vitit 1998 dhe 2001, kanë treguar rritje të qëndrueshme kundrejt vitit të kaluar, ashtu që në vitin e apostrofuar 2004, kur formohet "ADKOM" ato kanë arritur nivelin e 58.877.134 denarë ose 957.500 euro, ndërsa fitimi në fund të vitit ka qenë 9.190.281 denarë ose rreth 149.500 euro. Tashmë vitin e ardhshëm 2005, kompania gati se i dyfishon të ardhurat, duke pasur parasysh se bilanci financiar është i përfaqësuar përmes të ardhurave prej 94.831.870 denarë ose rreth 1.542.000 euro, prej të cilave pas heqjes së shpenzimeve, ka mbetur fitim prej 14.493.424 denarë ose 235.500 euro.



Приходите и добивката на Техноскуп бележат поинтензивен раст во годините по формирањето на АДКОМ во 2004 година и по назначувањето на сопругата на сопственикот и сестра на управителот на компанијата за овластено лице на здружението на комунални претпријатија во 2010 година.

ГОДИНА	ПРИХОДИ	РАСХОДИ	ДОБИВКА
1995	2.752.379	2.663.654	88.725
1996	5.047.528	4.890.535	156.993
1997	14.172.815	13.451.458	721.357
1998	11.426.092	10.983.109	372.479
1999	15.453.356	14.320.733	929.251
2000	26.669.097	25.100.398	1.333.992
2001	18.944.936	18.144.221	680.608
2002	25.051.980	22.289.133	2.378.986
2003	42.738.800	36.726.060	5.119.783
2004	58.877.134	48.065.039	9.190.281
2005	94.831.870	77.770.156	14.493.424
2006	115.659.395	95.621.618	16.855.173
2007	123.392.051	103.795.442	17.190.954
2008	120.251.811	83.075.516	33.449.829
2009	118.118.376	84.980.008	33.097.298
2010	122.784.848	82.403.396	40.275.134
2011	183.685.726	105.838.381	76.192.097
2012	175.349.411	125.515.143	49.625.017
2013	345.919.928	289.913.410	52.582.257
2014	153.740.041	138.010.872	13.806.406
2015	154.480.449	116.419.681	33.990.955
2016	261.231.721	216.219.066	40.042.922
2017	190.857.699	171.679.015	17.027.151
2018	217.817.609	212.198.066	4.431.587
ВКУПНО	2.599.255.052	2.134.034.437	465.220.615

Сумите се изразени во денари

Flukset financiare në arkën e "Tehnoskop" kryesisht rriten në vitet e ardhshme, kështu që në vitin 2010, kur gruaja e pronarit dhe motra e menaxherit të kompanisë bëhet person i autorizuar në "ADKOM" të ardhurat arrijnë në 122.784.848 denarë ose rreth 1.996.500 euro, ndërsa fitimi është 40.275.134 denarë ose rreth 655.000 euro. Vitin e ardhshëm 2011, ndërkaq, të ardhurat shënojnë një kërcim prej 183.685.726 denarë ose rreth 2.987.000 euro dhe fitimet arrijnë rekordin prej 76.192.097 denarë ose rreth 1.239.000 euro. Vetëm dy vjet më vonë, dmth. në vitin 2013, "Tehnoskop" shënon nivel rekord të lartë të të ardhurave madje 345.199.928 denarë ose rreth



This project is funded by the European Union



5.625.000 euro, por edhe shpenzimet kanë qenë më të larta dhe fitimi ka arritur në 52.582.257 denarë ose rreth 855.000 euro.

Si përmbledhje, në qoftë se mblidhen shifrat nga raportet financiare të "Tehnoskop" në periudhën 1995 – 2018, del se në këto 24 vite kalendarike, kompania ka realizuar të ardhura totale në vlerë prej 2.599.255.052 denarë ose 42.264.500 euro dhe shpenzimet totale në vlerë prej 2.134.034.437 denarë ose rreth 34.700.000 euro. Së këndejmi, në periudhën e apostrofuar, kompania për pajisje hidraulike ka realizuar një fitim prej 465.220.615 denarë ose rreth 7.564.500 euro. Në qoftë se kompania në vitet e para të formimit ka pasur vetëm tre të punësuar, numri i tyre nga viti në vit është rritur gradualisht, kështu që në vitin e kaluar 2018 ka pasur 19 të punësuar.

TENDERË TË VLEFSHËM SA GJYSMA E TË ARDHURAVE TË SHOQATËS, E CILA MË SË SHUMTI KA BASHKËPUNUAR ME UJËSJELLËSIN E SHKUPIT

Sipas të dhënave nga Byroja e Prokurimeve Publike, nga viti 2008 deri më tani, kur, në fakt, procedurat tenderke janë kryer në mënyrë transparente dhe evidentohen në mënyrë elektronike, "Tehnoskop" ka lidhur mbi 200 kontrata publike me vlerë mbi një miliardë denarë ose më saktë 17.5 milion euro. Kalimthi, në këtë shifër nuk janë marrë parasysh të ardhurat në bazë të një pjese të kontratave të veçanta të lidhura në kuadër të marrëveshjeve kornizë më të vjetra se 5 vjet, për shkak se ndërmarrjet publike nuk na i dorëzuan për këqyrje, duke u thirrur në Ligjin për lëndë arkivore, i cili kërkon që dokumentacionin ta ruajnë vetëm 5 vjet. Gjithashtu, nuk janë përfshirë shumë tenderë të vegjël me vlerë nën një milion denarë.

Për të marrë një pasqyrë të qartë për pjesën e mjeteve publike në kuadër të të ardhurave të kompanisë, duhet të krahasohen të ardhurat e "Tehnoskop" nga viti 2008 deri në vitin 2018, të cilat në total arrijnë 2.044.237.619 denarë ose rreth 33.240.000 euro, si dhe kontratat për prokurime publike në të njëjtën periudhë, vlera e përgjithshme e të cilave është 1.068.954.292 denarë ose 17.381.500 euro pa TVSH, të cilin nuk përlllogarisim sepse kompania si furnizues nuk e eidenton. Mbi këtë bazë, lartësia e kontratave të analizuara për prokurime publike të cilat io ka lidhur kompania përputhen me më shumë se gjysmën e të ardhurave që i ka realizuar gjatë periudhës së analizuar. Në fund të fundit, nuk mundet krejtësisht me saktësi të konstatohet se sa para publike kanë hyrë në arkën e kompanisë, sepse shumë kontrata parashohin se mallrat sigurohen sipas



nevojës ëdhe faturimi bëhet sipas dërgesës.



"Nga Tehnoskop thonë se likuiditeti dhe solventiteti i shoqërisë është më shumë rezultat i punës me kompanitë private, por nuk përgjigjen me precizitet se sa të holla publike po marrin pjesë në strukturën e të ardhurave"

„Të hyrat "Tehnoskop" i realizon në bazë të shitjes së materialeve hidraulike ndërmarrjeve publike të cilat marrin pjesë në qarkullimin e kompanisë, por mbështetja për realizimin e aftësisë paguese dhe likuiditetit të kompanisë tonë është e lidhur direkt me punën e kompanive private, duke pasur parasysh se kompanitë private ti përmbahen valutës për pagesë në bazë të kontratave të lidhura, që paraqet pjesë kryesore të punës sonë. Si një nga problemet me të cilat ballafaqohen në përgjithësi shumica e firmave në vend, mund të përmendim problemin me arkëtimin e debiteve në afatet ligjore", thonë nga "Tehnoskop", pa u përgjigjur saktësisht se sa para publike marrin pjesë në strukturën e të ardhurave.

Nga aspekti i vlerës së tyre totale, "Tehnoskop" më së shumti ka marrë nga NP "Ujësjiellës dhe kanalizime" nën ombrellën e Qytetit të Shkupit. Llogaritjet tregojnë se kontratat për prokurime



This project is funded
by the European Union



publike të cilat të dyja palët i kanë nënshkruan prej vitit 2008 deri më tani, arrijnë në 280.410.018 denarë ose rreth 4.559.500 euro pa TVSH, që përfaqëson më shumë se një të katërtën e numrit të përgjithshëm të kontratave për prokurime publike të cilat i ka lidhur kompania në të njëjtën periudhë. Kontratat më të mëdha ndërmjet "Ujësjellësit" të Shkupit dhe "Tehnoskop", janë lidhur për sistem të automatizuar të kontrollit me soft-starterë dhe rregullatorë frekuent në vitin 2017 prej 29.480.046 denarë ose rreth 479.500 euro me TVSH, për rregullacion automatik të elektromotorëve dhe stacioneve të pompimit në vitin 2012 prej 23.234.604 denarë ose rreth 378.000 euro për sistemin e leximit nga largësia së ujëmatësve në vitin 2009 prej 23.378.278 denarë (rreth 380.000 euro) etj..

TOP-15 KONTRATAT PËR PROKURIME PUBLIKE TË "TEHNOSKOP"

	Organi kontraktues	Lënda e prokurimit	Lloji i procedurës	Shuma e kontratave të lidhura	Data e kontratave të lidhura
01	Ministria e Transportit dhe Lidhjeve	Ndërrimi dhe instalimi i ujëmatësve shtëpiak, të kombinuar, industrial dhe tejetanor dhe integrimi i tyre në sistemin për lexim nga larg në sistemin e furnizimit me ujë të komunës së Kumanovës	Procedurë e hapur, në kuadër të së cilës lënda e prokurimit është ndarë në 2 pjesë, ashtu që Ministria ka lidhur kontrata me Tehnoskop për të dy lotet në vlerë prej 96.742.300 dhe 19.897.278 denarë.	116.639.578 den.	03.04.2018
02	NP Isar – Shtip	Furnizimi me material për ujësjellës dhe për kanalizim	Procedurë e hapur, në kuadër të së cilës lënda e prokurimit është ndarë në 4 pjesë, ashtu që ndërmarrja publike ka lidhur kontrata me Tehnoskop për dy lote në vlerë prej 29.382.732 dhe 53.653.024 denarë.	83.035.756 den.	27.06.2008



03	Ministria e Transportit dhe Lidhjeve	Prokurimi i pajisjeve për lexim	Procedurë e hapur, në kuadër të së cilës lënda e prokurimit është ndarë në 2 pjesë, ashtu që ministria ka lidhur kontratë me Tehnoskop për një lot	59.824.820 den.	28.03.2016
04	MJP Proakva	Furnizimi me tubacione dhe fittingë	Procedurë e hapur, në kuadër të së cilës lënda e prokurimit është ndarë në 3 pjesë, ashtu që ndërmarrja publike ka lidhur kontratë me Tehnoskop për një lot	44.947.489 ден.	23.04.2009 год.
05	Ministria e Transportit dhe Lidhjeve	Blerja e ujëmatësve shtëpiak të shumëfishtë, të kombinuar, industrial tejzanor me vendosje dhe integrim në sistemin për leximit nga largësia në sistemin e furnizimit me ujë të Probishtipit	Procedurë e hapur ku kanë marrë pjesë dy ofertues	37.319.652 den.	21.09.2015
06	NP Ujësjiellës dhe kanalizime - Shkup	Blerja e sistemit për drejtim automatik të soft startuesve dhe rregullatorëve frekuentë	Procedurë e hapur ku kanë marrë pjesë pesë ofertues	29.480.046 den.	13.11.2017
07	NP Ujësjiellës dhe kanalizime - Shkup	Blerja e sistemit për lexim nga largësia për ujëmatësit	Procedurë e hapur ku kanë marrë pjesë tre ofertues	23.378.278 den.	15.07.2009



08	NP Ujësjiellës dhe kanalizime - Shkup	Blerja e pajisjeve për rregullimin automatik të punës së elektromotorëve stacioneve të pompimit	Procedurë e hapur ku ka marrë pjesë një ofertues	23.234.604 de.	05.11.2012
09	NP Niskogradba Ohër - Ohër	Furnizimi me tubacione hekuri dhe pjesë fason për furnizimin me ujë	Procedurë e hapur ku kanë marrë pjesë tre ofertues	22.148.197 den.	11.11.2011
10	NP Solidarnost Vinicë	Blerja e materialeve për ujësjiellës	Procedurë e hapur, në kuadër të së cilës lënda e prokurimit është ndarë në 11 pjesë, ashtu që ndërmarrja publike ka lidhur kontrata me Tehnoskop për 4 lote në vlerë prej 7.982.684, 5.378.794, 5.018.579 dhe 3.760.433 denarë.	22.140.490 den.	24.12.2009
11	NPVK Komunalec - Strumicë	Furnizimi me pjesë fason prej hekuri, mbyllës fason, hidrante KZ, valvola servisi etj.	Procedurë e hapur, në kuadër të së cilës ndërmarrja publike ka lidhur kontratë me Tehnoskop në vlerë prej 19.045.397 denarë, por të dyja palët më vonë kanë lidhur edhe aneks të kontratës bazë në procedurë me negociata pa publikim paraprak të shpalljes në vlerë prej 3.065.175 denarë.	22.110.572 den.	15.04.2012/ 10.12.2012



12	NP Isar-Shtip	Furnizimi me puseta PE me dimensione të ndryshme, materiale ujësjellësi dhe kanalizimi për rikonstruktimin e linjave të ujësjellësit dhe linjave të kanalizimit	Procedurë e hapur, në kuadër të së cilës lënda e prokurimit është ndarë në 2 pjesë, ashtu që ndërmarrja publike ka lidhur kontratë me Tehnoskop për një lot	20.237.000 den.	14.11.2012
13	NP Ujësjellës dhe kanalizime - Shkup	Blerja e sistemit për drejtim automatik me rregullatorët frekuentë dhe soft startuesve SP Saraj, SP Svillarë	Procedurë e hapur në të cilën kanë marrë pjesë katër ofertues	17.315.675 den.	15.09.2015
14	NP Komunalec Kavadar	Blerja dhe montimi i sendeve hidraulike, ndërtimore, qarkullim-matësve dhe pjesëve të tjera për instalimin e sistemit SCADA	Procedurë e hapur në të cilën kanë marrë pjesë dy ofertues	16.052.873 den.	04.07.2012
15	NP Ujësjellës dhe kanalizime - Shkup	Blerja e soft starterëve dhe rregullatorëve frekuentë	Procedurë e hapur në të cilën ka marrë pjesë një ofertues	15.132.900 den.	12.02.2014

“Pesëmbëdhjetë levërditë më të vlefshme të Tehnoskop që nga viti 2008 deri më tani, sipas shumës së kontratës, respektivisht kontratave të lidhura në kuadër të një procedurë tenderimi “

LIDHJE FAMILJARE NDËRMJET NDËRMARRJES PUBLIKE DHE KOMPANISË-FURNITORE, PJESË E KONKURENCËS JASHTË LOJE

Sipas informatave të verifikuara, në "Tehnoskop" si komercialiste punon **Jana Apostolovska**, bija e e **Lujza Nakova-Karduloska**, udhëheqëse e departamentit për prokurime publike në "Ujësjellësin" e Shkupit. Edhe pse në fushëveprimin këtij shërbimi, ndër të tjera, bie përgatitja e dokumentacionit të tërësishëm për realizimin e prokurimeve publike, megjithatë, nga “Ujësjellësi” i Shkupit thonë



se nuk ka asgjë kontestuese në atë se kreu i këtij shërbimi është një i afërm i një punonjësi në një kompani e cila ka marrë tendera nga ndërmarrja publike. Nga "Tehnoskop", megjithatë, theksojnë se nuk i selektojnë dhe nuk i vlerësojnë punonjësit për nga marrëdhëniet farefisnore, miqësore dhe afariste, por, siç thonë nga atje, punësimi kryhet në përputhje me dispozitat ligjore, me shpallje të publikuar paraprakisht dhe periudhë provuese 6 mujore.



"Nga Ndërmarrja publike e ujësjellësit në Shkup pohojnë se udhëheqësi i prokurimeve publike nuk ka kontakt të drejtpërdrejtë me përgatitjen e specifikacioneve teknike"

"Udhëheqësi i prokurimeve publike nuk merr pjesë në planifikimin e nevojave vjetore të sektorëve dhe në përgatitjen e specifikacioneve teknike të planit të prokurimeve. Ato përgatiten në sektorët e kërkuesve të prokurimeve nga ana e ekspertëve të kompanisë. Komisionet për prokurime publike, sipas nenit 39 të Ligjit për prokurime publike, e zbatojnë dialogun teknik me operatorët ekonomik, hapjen e ofertave, përcaktimin e aftësisë së operatorëve ekonomikë, kontrollimin e propozimeve teknike, kontrollimin e ofertave të parashtruara nga ofertuesit në lidhje me çmimin, përcaktimin e ofertave të papranueshme dhe të pranueshme ... Personat dhe udhëheqësi në formën organizative të cilët kryejnë veprimtari në fushën e prokurimeve publike nuk mund të ndikojnë mbi komisionet e



prokurimeve publike dhe propozimet e tyre për përzgjedhjen e ofertuesve më të mirë", deklaruan nga "Ujësjetllësi dhe kanalizimet - Shkup".

Këqyrja në raportet e procedurave të zbatuara për kontratat më të mëdha dhe më të rëndësishme për prokurime publike të lidhura mes NP "Ujësjetllës dhe Kanalizime" dhe kompanisë "Tehnoskop", që i siguroam në përputhje me Ligjin për qasje të lirë në informata me karakter publik, nxjerr në pah se në një pjesë të këtyre procedurave, komisionet e formuara për zbatimin e prokurimit publik pranë ndërmarrjes së ujësjetllësit, shpeshherë diskualifikohen kompanitë konkurrenente të "Tehnoskop"-it. Një nga këto procedura ka të bëjë me blerjen e ujëmatësve, në kuadër të së cilës "Ujësjetllësi" i Shkupit ka lidhur kontratë me "Tehnoskop" në fund të vitit 2010. Më saktë, kompania është ftua për të dorëzuar një çmim përfundimtar, që ka qenë 7.212.300 denarë ose rreth 117.000 euro pa TVSH, e që është më shumë krahasuar me ofertat fillestare të firmave konkurruese "CMC Ekogon" dhe "Kaz Group" në vlerë prej 6.585.500 ose rreth 107.000 euro, respektivisht 6.347.928 denarë ose rreth 103.000 euro. Megjithatë, këto dy kompani u eliminuan në fazën e evalvimit.

Ligji për Prokurimin Publik definon se procedura e evalvimit është një nga fazat fillestare të procedurës së tenderimit, brenda së cilës kontrollohet kompletimi dhe vlefshmëria e dokumentacionit të operatorëve ekonomik të cilët kanë dorëzuar ofertë në hapjen publike. Respektivisht, evalvimi bëhet ekskluzivisht në bazë të kriterëve të përcaktuara në dokumentacionin tenderik, kështu që ofertat e pranueshme renditen me propozim për përzgjedhjen e ofertës më të favorshme. Kur në kushtet e tenderit është paraparë edhe ankandi elektronik si fazë përfundimtare, thirren të gjithë ata që kanë dorëzuar ofertë të pranueshme që të paraqesin çmime të reja. Mirëpo, nëse është paraqitur ose ka mbetur vetëm një ofertues, atëherë organi kontraktues detyrimisht e thërret që të paraqesë një çmim final ose në të kundërtën si çmim i fundit do të konsiderohet oferta e tij fillestare.

KONKURRENCË REAL E APO FIKTIVE – NJË PUNONJËS E KA MARRË KOMPANINË E THEMELUAR NGA PRONARI

Informacionet nga raporti mbi zbatimin e një procedure tjetër tenderike, nxjerrin në pah se ekziston lidhje mes pronarit të "Tehnoskop" dhe një tjetër kompanie për pajisje hidraulike. Në kuadër të procedurës së tenderimit, "Ujësjetllësi i Shkupit për furnizim me tapa (balona) në skadim të vitit



2017, në fazën e evalvimit janë diskualifikuar kompanitë "AntiPlam Toni" dhe "Alki Aleksandar," për shkak se kanë dorëzuar broshurë, katalog apo prospekt joadekuat. Pastaj, në ankandin elektronik janë ftuar "Tehnoskop" dhe "Matam Ing", me ç' rast "Tehnoskop" ka rezultuar fitues, duke ofruar një çmim prej 5.099.969 denarë ose rreth 83.000 euro, që ka qenë për vetëm 54.254 denarë apo rreth 800 euro më e ulët se sa 5154.223 denarët ose rreth 83.800 eurot e foruara nga ana e "Matam Ing". Sipas dokumenteve nga Regjistri Qendror, "Matam Ing" është formua nga Stojanovski në vitin 2007, por në vitin 2016 pronar i ri i "Mtam Ing" bëhet **Bobo Damjanovski**, i cili është ishi punësuar në "Tehoskop".

"Në treg u aprovua notimi mbi bazën e çmimit më të ulët në vitin 2007, ndërsa "Tehnoskop" si kompani që punon me një rejting të lartë dhe me cilësi të renomuar në treg që është edhe e dallueshme në treg që nga fillimi i ekzistencës së saj, nuk mund të konkuronte me nivelin e ulët të çmimeve në ankandet publike që ishin segmenti kyç për marrjen e procedurave të tenderit, megjithëse kjo përkonte me ofrimin e materialeve me cilësi të ulët. Për këto arsye u krijua "Matam Ing", e cila garante në treg konkurronte duke ofruar materialeve me çmime më të ulta dhe me cilësi shumë më të ulët të produkteve. Me kompaninë "Matam Ing" ne kemi konkurrencë në treg, pasi ne ofrojmë produkte të ndryshme, nga prodhues të ndryshëm dhe me çmime dhe nivel të ndryshëm të cilësisë", thotë Popllazarov, drejtues i "Tehnoskop".

Број на оглас	Договорен орган	Предмет на договорот	Вид на договор	Вид на постапка	Датум на договор	Носител на набавката	Процентна вредност без ДДВ	Вредност на договорот	Датум на објава
44/2016	ЈП Водовод и канализација - Скопје	систем за управување со софит стартери и фреквентни регулатори - по спецификација.	Стоки	Отворена постапка	13.09.2016	Друштво за трговија и услуги МАТАМ-ИНГ ДООЕЛ Скопје	30.000.000,00ден.	35.181.195,87ден.	15.09.2016
34/2016	ЈП Водовод и канализација - Скопје	Возило со камера за снимање на канализациони мрежи при прием за нивно одржување - по спецификација	Стоки	Отворена постапка	18.08.2016	Друштво за трговија и услуги МАТАМ-ИНГ ДООЕЛ Скопје	10.000.000,00ден.	11.798.901,00ден.	23.08.2016
0507-3856/2017	Акционерско друштво Водостопанство на Република Македонија, во државна сопственост, Скопје	Набавка на материјали за одржување на системите	Стоки	Отворена постапка	13.03.2018	Друштво за трговија и услуги МАТАМ-ИНГ ДООЕЛ Скопје	13.680.000,00ден.	2.447.734,00ден.	29.03.2018
	ЈПНД Комуналец - Гевгелија	ФРЕНВЕНТЕН РЕГУЛАТОР за работа на потопни пумпи до 40 kw на бунарско подрачје Моин.	Стоки	Постапка со преговарање без претходно објавување на оглас	29.08.2016	Друштво за трговија и услуги МАТАМ-ИНГ ДООЕЛ Скопје	531.000,00ден.	489.700,00ден.	26.07.2017
0507-16/7/2017	ЈПНД Брегалница Делчево	Водоводни материјали	Стоки	Отворена постапка	05.06.2017	Друштво за трговија и услуги МАТАМ-ИНГ ДООЕЛ Скопје	3.000.000,00ден.	463.065,04ден.	24.07.2017

"Kontratat për prokurim publik të lidhura nga Matam Ing"



Sipas të dhënave të Byrosë së Prokurimit Publik, pas ndryshimit të fundit në strukturën e pronësisë së "Mata Ing" kur pronar dhe menaxher bëhet një ish-punonjës i departamentit të kontabilitetit dhe financave në "Tehnoskop" - Damjanovski, kompania ka nënshkruar 5 kontrata për prokurime publike me vlerë totale 50.380.595 denarë ose rreth 819.000 euro. Më me vlerë është kontrata me "Ujësjiellësin" e Shkupit për sistemin për menaxhim me soft-starterët dhe të rregullatorët frekuentë, e nënshkruar në vitin 2016 në vlerë prej 35.181.195 denarë ose rreth 572.000 euro, por vlen të veçohet kontrata në mes të dy palëve të të njëjtës periudhë për automjet me kamerë incizimin e rrjeteve të kanalizimeve në vlerë prej 11.798.901 denarë ose rreth 192.000 euro. Megjithatë, Damjanovski thotë se përballet me vështirësi në punë dhe se ka ofruar shitjen e kompanisë me të gjitha debitet dhe kreditit.

"Si ish-punonjës i kompanisë "Tehnoskop, e braktisa vendin e punës për shkak të shkuarjes time në Australi. Por, për shkak të rrethanave të krijuara, u ktheva në Maqedoninë e Veriut dhe pasi mendova gjatë hapa biznesin tim. Duke njohur sferën e pajisjeve të ujësjiellësit, vendosa të merrja kompaninë "Matam Ing", me qëllim që të depërtoj në treg dhe të krijoj të ardhura mujore. Ndërkohë, duke pasur parasysh konkurrencën e fortë, vështirë shkon depërtimi në treg dhe konkurrenca me firmat në atë veprimtari. Situata në treg është e vështirë dhe përballet me konkurrencë të fuqishme dhe mospagesë të borxheve si edhe të gjitha kompanitë në vend. Gjithashtu, aktualisht jam duke u përballur me padi me kompanitë me të cilat kam bashkëpunuar. Njëherit, do të doja të theksoja se kemi ofruar shitjen e kompanisë me të gjitha kërkesat dhe obligimet nga shkakut se përsëri më hapet mundësia për të shkuar jashtë vendit", shpjegon Damjanovski, pronar i "Matam Ing".

INSISTIM PËR CERTIFIKATË NGA ASOCIACIONI I PRODHUESVE, NË VEND TË STANDARDIT ADEKUAT LIGJOR

Në lidhje me procedurat e tenderimit në të cilat ka marrë pjesë "Tehnoskop", kanë reaguar kompani të cilat konsiderojnë se në mënyrë të padrejtë dhe të paligjshme u është pamundësuar të marrin pjesë në procedurë. Kompania për prodhimin e pajisjeve hidraulike "Kaz Grup" është një kompani udhëheqëse për nga ankesat e parashtruara për pajisje hidraulike, të cilat përmbajnë pretendime se ka pasur shkelje ligjore në zbatimin e procedurave të tenderimit nga ana e ndërmarrjeve publike



komunale. Në fakt, për "Kaz Group" është kontroverse ajo se NP "Ujësjellës dhe kanalizime – Shkup", në pjesën e mbrojtjes anti-korrozive të produkteve të ujësjellësit, e kërkon të ashtuquajturën certifikatë GSK, certifikatë e cila nuk paraqet standard përkatës, por lëshohet në bazë të rregullativës interne RAL të asociacionit të prodhuesve të pajisjes hidraulike.



"Një pjesë e kompanive për ujësjellës kanë kontestuar një sërë procedurash të tenderimit para komisionit kompetent, duke akuzuar për diskriminim dhe favorizim"

Sipas "Kaz Group", kjo është në kundërshtim me nenin 33 paragrafi 2 alineja 1 të Ligjit për prokurime publik, i cili thotë: *"Organi kontraktues e definon specifikimet teknikeme udhëzim, si rregull sipas rendit të mëposhtëm - zbatimi i standardeve të Maqedonisë në përputhje me Standardet evropiane, leje teknike evropiane (atëste teknike evropiane), specifikacione të përbashkëta teknike që përdoren në BE, standarde teknike ndërkombëtare ... "*. Nga atje precizojnë se insistimi për certifikatën GSK paraqet mënyrë për të mundësuar që në procedura të marrin pjesë vetëm anëtarët e asociacionit GSK, gjë që njëkohësisht është në kundërshtim me nenin 210, paragrafi 1, alineja e Ligjit për Prokurim Publik, i cili parashikon se nëse dokumentacioni i tenderit nuk është në përputhje me ligjin, mund të çojë deri në diskriminim të operatorëve ekonomikë ose në kufizimin e konkurrencës së tregut.



"Rregullativa e cituar RAL GZ-662 nuk është as standarde, as leje teknike evropiane (atest teknik) e as referencë teknike e aprovuar nga ndonjë organ evropian standardizimi. Përkundrazi, ajo paraqet të ashtuquajturën rregullativë interne vetëm të asociacionit të prodhuesve GSK, ndërsa certifikata GSK është dokument të cilin ua lëshuojnë vetëm anëtarëve të vet dhe askujt tjetër. Për specifikimin e pjesëve hidraulike që janë me mbrojtje anti-korrozioni për kushte të vështira, duke e zbatuar paragrafin 2 të nenit 33 të Ligjit për prokurime publike, ekziston një standard adekuat për këtë dedikim dhe i njëjti është MKS EN 14901: 2014 ", shpjegojnë nga "Kaz Grup" në serinë e ankesave drejtuar Komisionit.

Përveç kësaj, "Kaz Grup", ka dëshmuar se certifikatën GSK nuk paraqet as garanci për kualitetin e produkteve. Argumenti i parë i kompanisë në atë drejtim bazohet në të dhënat se asociacioni GSK prej të gjithë 18 standardeve të deklaruara me të cilat lëshohet certifikata GSK, është e akredituar vetëm për një standard (EN ISO 4624), duke pasur parasysh se, siç pohojnë nga kompania, këtë ia kanë konfirmuar nga instituti MRA të Hanoverit, se kush i bën ekzaminimet për asociacionin GSK. Si argumenti i dytë e cekin faktin se organi kontraktues për disa produkte kërkon ekskluzivisht certifikatë GSK, ndërsa për produkte tjera të njëjta apo të ngjashme, nga e njëjta linjë e ujësjellësit kërkon mbrojtje anti-korrozive që të ndërtohet me material i cili nuk e rrezikon shëndetin e njerëzve, pa mos insistuar me këtë rast për certifikatin.

FILTRIM I KONKURRENCËS SË PAPËRSHTATSHME OSE GARANCI PËR KUALITET?

Pretendimet e këtilla se "Ujësjellësi" i Shkupit zbaton procedura të paligjshme, përmes filtrimit të konkurrencës duke kërkuar të ashtuquajturën certifikatë GSK, e cila nuk është e bazuar në asnjë standard ligjor, por paraqet një dokument të cilin asociacioni e lëshon për anëtarët e vet në bazë të rregullores interne RAL, me ç'rast prej të gjitha 18 standardeve të deklaruara në bazë të cilit e lëshon dokumentin është e akredituar për vetëm një, "Kaz Grup" i ka shpalosur në ankesën për tenderin për rikonstruktimin, ndërtimin shtesë dhe zëvendësimin e gypave të ujësjellësit të vitit të kaluar 2018. Mbi ankesën e kompanisë, Komisioni për Ankesa mbi prokurimet publike që funksionon si një organ i pavarur shtetëror, vendos ta anulojë procedurën e tenderit, me ç'rast në mënyrë të qartë dhe pa mëdyshje vë në dukje se:



"Organi kontraktues gjatë zbatimit eventual të sërishëm të procedurës për prokurim publik është e nevojshme që gjatë përgatitjes së dokumentacionit të tenderit të ketë parasysh dispozitat e Ligjit për prokurime publike në lidhje që kanë të bëjnë me përgatitjen e specifikacioneve teknike, si dhe dispozitat që lidhen me kërkesën dhe zbatimin e standardeve të caktuara ". Në vazhdim, Komisioni rikujton nenin 36 të Ligjit për prokurime publike, sipas të cilit: "Organi kontraktues nuk guxon të definojë specifikacione teknike të cilat çojnë në prodhim konkret , realizim, proces të caktuar apo marka tregtare, llojet patente ose origjine specifike të mallrave me qëllim të favorizimit ose eliminimit të operatorëve ekonomikë ose mallrave të caktuara“ .



"Pasi që ka anuluar një prej procedurave tenderike të ankimuar, Komisioni i Ankesave të Prokurimit Publik ka kërkuar nga organi kontraktues që gjatë përgatitjes së specifikacionit teknik të mos i referohet prodhimit konkret, realizimit, procesit ose markave tregtare të caktuara“

Kundrejt kësaj, Komisioni për prokurime publike pranë "Ujësjiellësit" të Shkupit, ka pohuar se certifikata GSK nuk është kusht diskriminues, por, sipas tyre, shenja e cilësisë RAL Qualitis Mark e GSK RAL Q3 662 tregon siguri të lartë dhe garanton standard të pamohueshëm për mbështjellje nga korrozioni të valvulave dhe fitngjeve me mveshje pluhuri. Prej atje theksojnë se asociacioni GSK Shoqata u ndan shenjen për cilësi vetëm kompanive që i plotësojnë kushtet dhe i përmbushin



kërkesat për cilësi. Njëherit, ata theksojnë se certifikata GSK posedojnë kompanitë më të renomuara që prodhojnë valvulave dhe pjesë të ujësjellësit, me çka përdëftojnë cilësi në drejtim të mbrojtjes anti-korrozive.

"Deri më tani nuk kanë ekzistuar direktiva maqedonase ose evropiane që e kanë përdëftuar mbrojtjen më cilësore nga anti-korozioni i valvulave dhe fittingjeve me mveshje pluhuri. Certifikimi GSK ka përcaktuar prova për rregulla të pranuarra të teknologjisë në korniza botërore si kulm në fushën e mbrojtjes anti-korrozive. Certifikata e lëshuar GSK, respektivisht shenja e cilësisë RAL Qualits Mark e GSK RAL Q3 662 do të thotë siguri e lartë, kualitet dhe garanton standard të pamohueshëm për veshje, duke siguruar zgjidhje adekuate për rrjete të furnizimit me ujë të pijshëm, ujëra të zeza dhe gaz", thonë nga Komisioni për prokurime publike pranë ndërmarrjes publike.

NDËRMARRJA PUBLIKE E KA ANULUAR PJESËN E PROKURIMIT TË CILËN E KA MARRË ANKUESI

Në përgjigjet të cilat na i ofruan, nga "Tehnoskop" thonë se ata posedojnë certifikatë GSK, por një procedurë ankimore e parashtruar nga "Kaz Grup" zbulon se kompania e ka deponuar këtë dokument. Konkretisht, kemi të bëjmë me prokurimin e qaforeve hidraulike, në kuadër të të cilave "Ujësjellësi" i Shkupit fillimisht ka lidhë marrëveshje kornizë me "Tehnoskop" dhe "Mitelmont" për katër lote, me çka "Tehnoskop" ka qenë i ranguari i parë për listat 2 dhe 4, ndërsa "Mitelmont" për listat e 1 dhe 3. Për shkak se është eliminuar nga procedura për arsye të thjeshtë se nuk ka poseduar certifikatën e kërkuar, "Kaz Grup" e ka apeluar procedurën, duke pretenduar se posedojnë dokumentacionin e plotë dhe kanë deponuar vërtetim të lëshuar nga një laborator i akredituar.

Në aktvendimin e Komisionit ceket se "Tehnoskop" ka ofruar qafore të IMP Armature, Slloveni, me certifikatë GSK për tre lista, si dhe HOUT, Francë, me certifikatë nga "Instituti për inspektimin e cilësisë", Zagreb, për listën e katërt. Sa i përket "Mitelmont", kjo kompani ka ofruar qafore për të gjitha listat e Hawle, Gjermani, me certifikatë GSK. Nga "Kaz Grup" kanë akuzuar se dokumentacioni i të dy kompanive është jovalid sepse laboratorët në të cilat ato janë thirrur nuk janë të akredituara. Ndërkaq, nga ndërmarrja publike kanë akuzuar se ankuesi kishte dorëzuar dokumentacion të pakompletuar, pasi që përfshinte vetëm analiza kimike, por jo edhe inspektime në



përputhje me standardet teknike.

Mirë, ama, Komisioni për ankesa ka vlerësuar ankesa e “Kaz Grupit” është e bazuar sepse ndërmarrja publike gabimisht e ka konstatuar gjendjen faktike dhe ka bërë shkelje gjatë evalvimit të ofertave. Pasi që procedura është kthyer në fazën e vlerësimit, është zhvilluar një procedurë e re, në kuadër të së cilës lista e parë dhe e tretë për ofertuesi më të volitshëm u zgjodh përsëri "Mitelmont" ndërsa për listën e dytë dhe të katërt, prokurimi është anuluar me vendim të ndërmarrjes publike. Gjegjesisht, “Ujësjiellësi” i Shkupit ka sjellë vendim të këtillë menjëherë pasi ofertë më të volitshme ka parashtruar ankuesi "Kaz Grup", me shpjegimin se për shkak të rrethanave të paparashikuara dhe objektive kanë ndryshuar nevojat e organit kontraktues, pa dhënë detaje në lidhje me rrethanat e tilla.

"Aktualisht, kompania jonë sipas asortimentit, cilësisë dhe specifikës së produkteve të veta është një nga kapacitetet më të mira prodhuese në Ballkan në branshën e vet. Në të gjitha eksportet e deritashme, ne nuk kemi pasur ankesa në lidhje me produktet tona. Përkundrazi, partnerët e huaj janë të befasuar këndshëm nga cilësia e kontrolluar dhe e qëndrueshme, respektimi i afateve të dërgesës, logjistika e plotë. Me certifikatat me të cilat disponojmë, në vendet evropiane jemi të barabartë me të gjithë prodhuesit e renomuar, gjë që nuk është rasti në vendin tonë, ku veçanërisht nëpërmjet kriterëve të pabaza dhe certifikatave, siç është certifikata GSK, shpeshherë për fat të keq dhe për ironi, kemi qenë të skualifikuar apo të pamundësuar që t'i plasojmë produktet tona", thonë nga Kaz Grup.



This project is funded
by the European Union



"Me certifikatat me të cilat disponojmë, në shtetet evropiane jemi të barabartë me të gjithë prodhuesit e njohur, gjë që nuk është rast në shtetin tonë ku përmes kriterëve dhe certifikatave të pabazuara, siç është certifikata GSK, shpeshherë jemi diskualifikuar", reagojnë nga Kaz Grup.

EKSPERTËT SHOHIN KONFLIKT INTERESI, RASTI NËN THEJRRËZËN E ANTI-KORRUPSIONERËVE

Duke i pasur parasysh të gjitha faktet dhe njohuritë e shpalosura, ish anëtari i Komisionit antikorrupsion **Arif Musa** bën me dije se kontratat për prokurime publike në mes të "Tehnoskop" dhe ndërmarrjeve komunale publike duhet të shqyrtohen nga Komisioni për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit. Në lidhje me këtë, Ligji për shoqata dhe fondacione, në bazë të të cilit funksionon "ADKOM" përcakton se *"konflikt interesit nënkupton një konflikt të autorizimeve dhe detyrave që lidhen me punën e organizatës me interesin privat të personit i cili ka autorizime dhe obligime, në interesin privat ndikon ose mund të ndikojë në performancën e kompetencave dhe detyrave në lidhje me punën e organizatës"*. Përveç kësaj, Ligji i ri për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit përcakton se *"personi zyrtar nuk mund të ushtrojë ndikim të paligjshëm në procedurën e prokurimit publik"*,

"Në fushëveprimin e punës së ADKOM nuk hyjnë tema për diskutim rreth prokurimeve publike. Për shpenzimin e mjeteve të tyre (ndërmarrjeve publike), ato u raportojnë organeve komunale. Motoja jonë në punë është profesionalizmi, përgjegjësia dhe ligjshmëria. Këtë e konfirmon puna jonë 15 vjeçare e suksesshme dhe cilësore, kënaqshmëri dhe nota të larta nga të gjithë partnerët tanë nga vendi dhe jashtë", thonë nga Shoqata e ndërmarrjeve publike, nga ku në lidhje me çështjen se me çfarë rregulla statusore e kanë rregulluar konfliktin e interesit, u përgjigj se kjo është obligim ligjor vetëm për shoqatat me autorizime publike.





"Komisioni për parandalim të korrupsionit dhe konflikt të interesave, konsideron se ekzistojnë indicie të mjaftueshme për të hapur lëndë për rastin"

Nga Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit, i cili ka të drejtë të veprjë ex officio, por edhe pas denoncimeve të marra, na njoftuan se nuk kanë indicie të mjaftueshme fillestare për të hapur lëndë për rastin, në kuadër të të cilit duhet të shqyrtohet nëse ka konflikt interesi dhe ndikim në prokurimin publik. Me kërkesë të Komisionit, i dorëzuar të gjitha informacionet dhe të dhënat deri tek të cilat erdhëm dhe me të cilat disponojmë si rezultat i këtij hulumtimi në lidhje me relacionin ndërmjet shoqatës ku janë organizuar ndërmarrjet komunale publike "ADKOM" dhe kompanisë private "Tehnoskop", e cila në një farë mase ka punuar me këto subjekte.

"Duke pasur parasysh se informacionet në lidhje me prokurimet publike të ndërmarrjeve publike në vendin tonë janë të shpallura publikisht dhe janë të qasshme përmes sistemit elektronik të prokurimeve publike, "Tehnoskop" si dhe kompanitë e tjera private, e shfrytëzojnë të njëjtën mënyrë të informimit për shpalljet e publikuara. Që nga formimi i vet, "Tehnoskop" punon kryekëput në përputhje me dispozitat ligjore, rregullat dhe rregullativën dhe vepron mbi të njëjtën", thonë nga " Tehnoskop" duke u përgjigjur në pyetjen se sa lidhja e kompanisë me "ADKOM" është parimore dhe korrekte, nga aspekti i se mund të shfrytëzohet për lobim, të kuptuarit e planeve të caktuara për prokurime publike, kriteret dhe kushtet në dokumentacionin tenderik dhe specifikacionin teknik?



Kjo storje hulumtuese është përpunuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e saj është përgjegjësi e vetme e autorit dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



This project is funded
by the European Union

